



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0938

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE PRO MEDICAL SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “SERVISIMI I PAJISJEVE MJEKËSORE – RITENDERIM” me numër të prokurimit 623-24-8427-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, më 02/12/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE Pro Medical Sh.P.K., me nr. 2024/0938, e datës 03/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-24-8427-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit..
2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Rahovecit, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 15.08.2024 Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-24-8427-2-2-1.

Ndërsa me datën 18.09.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE “Atom -Med.”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 30,000.00 €.

Me 23.09.2024 OE Pro Medical Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Pro Medical Sh.P.K., me nr. 0938/2024 lidhur me aktivitetin “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-24-8427-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Pro Medical Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “Arsytimi i OE për Pretendimin 1 ndaj AK-së: Ne kemi dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas kërkesës së AK-së më datë 29.08.2024, duke përmbytur të gjitha kërkesat në formë elektronike dhe në formë fizik pra edhe origjinalin kemi dozuar, pra ritheksim ne kemi dorëzuar edhe dokumentet e kërkuara edhe në formë fizike, të cilat janë origjinale. Dokumentet e listuara më poshtë janë dorëzuar si në mënyrë fizike ashtu edhe në formë elektronike. Pra, bazuar në dëshmitë e dorëzuara si në formë elektronike ashtu edhe fizike (origjinale), ne kemi plotësuar kriterin e përmendur më sipër, dhe pretendimet e AK-së për eliminimin tonë janë të pabazuara.”

Pretendimi i dytë (II) : “Arsytimi i OE për Pretendimin 2 të AK. Ne kemi dorëzuar listën e projekteve me vlerë totale prej 1,686,408.48 euro, ku vetëm shërbimet apo servisimi kapin vlerën prej 427,301.24 euro. Ne kemi dorëzuar vetëm një pjesë të referencave dhe raporteve të pranimit, sepse kemi paraqitur referenca të mjaftueshme besoj që plotësojnë këtë kriter, por kemi akoma raporte te pranimit të shërbimeve që nese kërkohet nga AK ado to dorzohen konfrom Neni 72. Gjithashtu, AK ka pasur mundësinë, sipas Nenit 72 dhe Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, të kërkojë informacion shtesë, sipas udhëzimeve në vijim, dhe jo të refuzojë ofertën tonë pa respektuar Udhëzuesin Nr.001/2023 për Prokurimin Publik. 5 / 9 AK mund të kishte marrë informacionin dhe sqarimet e nevojshme në përputhje me Nenin 72 të LPP-së dhe Udhëzuesin Nr.001/2023, pika 10.1. Pra mund të ritheksojm se në listën e dorëzuar të projekteve e cila ka vlerën totale prej 1,686,408.48 euro, ku vetëm shërbimet apo servisimi kapin vlerën prej 427,301.24 euro. “

Pretendimi i tretë (III) : “Arsytimi i OE për Pretendimin 3 të AK. Verifikimi dhe noterizimi i certifikatës ISO 9001 është kryer nga Noteri në përputhje me Ligjin Nr. 06/L010 për Noterinë. Për më shumë detaje, ju lutem referojuni emailit të konfirmimit dhe interpretimit ligjor të Noterit lidhur me pretendimin tuaj për eliminimin tonë në lidhje me certifikatën ISO 9001. Ju si Autoritet Kontraktues (AK) keni pasur mundësinë të kërkonit informacion shtesë në lidhje me këtë çështje, në përputhje me LPP Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë-Prandaj, autoriteti kontraktues, në përputhje me Nenin 59.2 dhe Nenin 72, ka pasur mundësinë të kërkojë sqarime nga ne e jo të eliminon nga ky aktivitet prokurimi, në kundërshtim me LPP Neni 59.2 dhe Neni 72 dhe A02_Udhëzues Nr-001_2023 per prokurimin publik piken 10.1 pra, ku në bazë Neni 72 paragarfi 2 “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji (ky citat është nga Ligji Nr. 04/L-042 7 / 9 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-

092(Versioni i Konsoliduar). Ju lutem, shikoni emailin më poshtë ose emailin si dëshmi nga Noteri, lidhur me arsyetimin tuaj për eliminimin tonë, i cili është i pabazuar, sepse, citoj: ” kopje e dokumentit të certifikuar apo kopje e zakonshme e dokumentit origjinal dhe ne kete rast noteri deklaroi qe kopja perputhet me qdo aspekt me kopjen me pare se me dokumentin origjinal qe nuk eshte prezentu, munde te verteton si kopje e zakonshme “ Ose ju lutem shikoni emial si provë e bashkangjiture kësaj ankese. Ju lutem shikoni emial si provë e bashkangjiture kësaj ankese. Pra Vendimi i AK bie ndesh me Nenet të cekur me lartë arsyetimet e cekur me lartë të AK bie ndesh me LPP. Pjesa II AK në kundërshtime me LPP Neni 59, i cili trajton Ekzaminimin, Vlerësimin dhe Krahasimin e Tenderëve, ka rekomanduar një Oferues Ekonomik (OE) që nuk ka plotësuar Fletën e Dhënies së Tenderëve (FDT). Ne besojmë se ky OE i rekomanduar nuk ka vepruar me përgjegjshmëri. Gjithashtu, është evidente se Autoriteti Kontraktues (AK) ka aplikuar standarde të dyfishta ndaj nesh, duke na diskriminuar si kompani dhe duke favorizuar OE-në e rekomandua. Pjesa II - Pretendimi 4 i OE Pro Medical ndaj OE të rekomanduar për kontratë nga AK. Kontrate e punës se OE të rekomanduar për Andi Jashari dhe Trinor Salihu pra kontrate nuk janë komplet pra këto kontrata kanë 5 faqe kurse OE i rekomanduar ka dërguar faqen 1 dhe vetëm faqen 5 pra mungoj disa faqe edhe teknikish këto dokumente nuk janë kompletuar por përsëri AK e rekomandon për kontratë. 8 / 9 Gjithashtu kontrate e punëtorëve të cekur me lart janë bërë me daten 05.09.2024 kurse data e dorzimit të ofertave është 26.08.2024 pra vrehet qart se ky AK e ka favorzuar OE e rekomanduar për kontratë. Pra AK në kundërshtime me Rregullore për prokurimin publik 2022 citim ” Neni 38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet” Kurse Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve pragrafi 2 “Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Gjithashtu edhe Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë pragrafi 3 citim : “ Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.” Pra ka pranuar kontrate te notorizuar 05.09.2024 ose 10 dite pas jane dorzuar ofertat kurse LPP qart e përcakton se dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues. Për sa i përket argumenteve të përmendura më sipër, OE e rekomanduar duhet të eliminohet nga ky AK i prokurimit dhe nuk duhet të rekomandohet për kontratë. Është e qartë se OE ka favorizuar një OE të caktuar, ndërsa ne jemi diskriminuar. AK nuk ka zbatuar nenet e cekura më lart gjatë vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Si pasojë, ne jemi eliminuar nga ky aktivitet, dhe kjo do të dëmtojë buxhetin e komunës, duke sjellë shërbime mbi çmimin e tregut.”

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në B42 Letër Standarde per tenderuesin e eliminuar, kemi cekur arsyetim për eliminimin tuaj: Ne ofertën e juaj të dorëzuar, mungon Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare; Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shembullin se si duhet vepruar: Ju si Operator Ekonomik, me datë: 29.08.2024, nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe ne formë fizike, nëpërmjet Protokollit Numër: 01-151/02-0035913/24, keni dorëzuar dokumentacionet vetëm për Kapacitetin Teknik dhe Professional, por ju si Operator Ekonomik NUK jeni përgjigjur ne kërkesën tonë sipas Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin për Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara. Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2 Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në B42 Letër Standarde per tenderuesin e eliminuar, kemi cekur arsyetim për eliminimin tuaj: Referenca/t ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses në lëmin e Shërbimeve të ngjashme, janë në vlerë: 14,999.10 Euro, ndërsa janë kërkuar në vlerë min. 45,000.00 Euro.

Referenca/t ose raportet e pranimit të tjera të prezantuara nga ana juaj janë kryesisht me Aktivitetet të furnizim, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara Ndërsa sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, thotë: me vet faktin që paragrafi i latë cituar përmend fjalën mund dhe jo kushtimisht duhet, dhe ne si AK kemi pranuar vetëm referencat që janë prezantuar ne Ofertën e dorëzuar në lëmin e Shërbimeve të ngjashme Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.. Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 3 Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, kemi cekur arsyetim për eliminimin tuaj: Në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali; Në Ofertën e prezantuar është dorëzuar Vërtetimi i Certifikatës nga Kopje nga Kopja e Zakonshme. Noteri në shkresën e tij, konfirmon duke cekur: me kërkesë që t'i vërtetoj kopjen e dokumentit nga kopja e zakonshme. Për këtë çështje kemi edhe Rekomandim nga Zyra Kombëtare e Auditimit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së Por edhe ne email te prezantuar nga Noteri thotë: është kopje e dokumentit te certifikuar apo kopje e zakonshme e dokumentit Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara. Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 4 Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kriteri i Dhënies është: Kriteret e Dhënies 30.1 Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët me poentim 9 Ku poentimi është ndarë në dy (2) kategori: 65% dhe 35%. Operatorin Ekonomik të rekomanduar, këtë pjesë e ka llogaritur tek 65% i poentimit, sipas Kriterit Çmimin më të ulët me poentim. Ndërsa ju si Operator Ekonomik ankues nuk e keni llogaritur këtë pjesë tek kategoria e poentimit. Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14/10/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0938/2024, ndërsa me datë 25/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0938 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Pro Medical Sh.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0938 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : “OE “Pro Medical ” ShPK-Ferizaj pretendon se A.K., Komuna e Rahovecit nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 1 të LPP-së . Ekspertja thekson se ndër tjera qëllim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të

shfrytzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen,si dhe të siguroj integritetin dhe pergjegjësinë e zyrtarëve publik. AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar , sepse oferta e dorëzuar nuk ishte në harmoni me te gjitha kriteret e parapara me Njoftimin per Kontratë dhe dosjen e tenderit edhe pse ishte oferta me çmimin ma te lirë . Andaj ,Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar..”

Konstatimi i dytë (II) : “OE “Pro Medical ” ShPK-Ferizaj pretendon se A.K., Komuna e Rahovecit nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së . Ekspertja sqaron se nderë të tjera qëllimi i nenit 6 të LPP-së është të udhëzohen autoritetet kontraktuese të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës. AK e ka trajtuar OE ankues si të si të eliminuar , sepse oferta e dorëzuar nuk ishte në harmoni me te gjitha kriteret e parapara me Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit Andaj , Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.”

Konstatimi i tretë (III) : “OE “Pro Medical ” ShPK-Ferizaj pretendon se A.K., Komuna e Rahovecit nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së . Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyr të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .Pretendimi i OE ankues: se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Ekspertja sqaron se sa i perket pretendimit të OE ankues ,i njejt pretendim është pjeserisht i bazuar sepse AK nuk ka nderrmarr veprime per të kerkuar sqarime lidhur me pretendimet e OE ankues per referenca apo raporte te pranimit lidhur me listen e kontratave që e ka dorëzuar me rastin e ofertimit OE ankues ,por pa kerkua informacion shtesë per kete pikë pretenduese e ka eliminuar edhe pse nuk ishte arsyeja vendimtare per eliminim por sidoqoft kur OE e dorezon listen e kontratave nuk mundë te eliminohet per referenca apo raporte te pranimit pa kerkua informacion shtesë me rastin e vleresimit bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjeserisht i bazuar.”

Konstatimi i katërt (IV) : “.OE “Pro Medical ” shpk-Ferizaj pretendon se A.K., Komuna e Rahovecit ka ra ndesh me nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe neni 40 të RRPP-së. Ekspertja thekson se qëllim i nenit 59 te LPP-së dhe neni 40 të RRPP-së,është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit,i cili pasi i ka vleresuarë ofertat e pranuar ka dhenë rekomandim dhe i njejt rekomandim është aprovuar nga udheheqesi i prokurimit ,ndersa qëllimi i nenit 72 është te ti udhëzojë autoritetet kontraktuese lidhur me mundësin e sqarimit te dokumentacionit dhe informacionit shtesë. Ekspertja sqaron se Autoriteti Kontraktues me rastine vlerësimit të ofertave, operatorin ekonomik ankues e ka trajtuar si Operator Ekonomik të eleminuar. Ekspertja sqaron se OE ankus pretendon se është eliminuar pa te drejtë për keto arsye:

Pretendimi 1:OE ankues nder te tjera pretendon se e ka plotsuar ketë kriter dhe pa te drejtë është eliminuar shih kriterin më posht per te cilin është berë pretendimi , Kërkesa 4 : Dy (2) Serviser me certifikate nga prodhuesi per servisim te pajisjeve kryesore Selectra pro m dhe Sfri H18; Dëshmia 4 :Certifikata trajnimi për Serviser të Certifikuar nga prodhuesi – Kopje; • CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); Ekspertja sqaron se OE ankues gabimisht ju ka referuar ketij kriteri sepse i njejt nuk ishte eliminuar për ketë arsye sepse AK ka kerkua sqarime edhe per ketë kriter ,edhe pse nuk ka pasur nevojë te kerkojë sqarime sepse ky kriter ishte ndryshuar me rastin e publikimit të B54 Formularin standard për korrigjimin me kete formular kriteri i permendur me lart tani është korrigjuar ne ketë formë si : Kërkesa 4 Dy (2) Serviser me certifikate nga prodhuesi per servisim te pajisjeve kryesore Selectra pro m dhe Sfri H18; Kerkesa 4 Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike; Se nuk ishte eliminuar për ketë kriter deshmohe edhe me Leter standarde e cila ishte derguar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK ,kjo vertetohet edhe me raportin e vleresimit ku AK per ketë kriter e ka vlerësuar oferten e OE ankues se është në pajtim . Andaj Ekspertja sqaron se OE ankues e ka plotsuar

ketë kriter dhe i njejt kriter nuk ishte kontestuar edhe nga ana e autoritetit kontraktues dhe pretendimi për ketë kriter ishte bërë gabimisht nga ana e OE ankues. Andaj Ekspertja vetem e sqaron se pretendimi nuk është i sakt sepse ky kriter nuk ishte kontestuar nga AK por vetem ka kërkuar sqarime dhe pas pranimit të sqarimeve është trajtuar se është në pajtueshmeri me kerkesat e parapara me NJK dhe DT. Andaj Ekspertja sqaron se ky pretendim është pa efekt juridik. Pretendimi 2:OE ankues nder te tjera pretendon se e ka plotsuar ketë kriter dhe pa te drejtë është eliminuar sepse ka dorezuar listen e kontratave dhe disa referenca por AK ka pasur mundesi qe te kerkohen sqarime edhe per disa referenca te tjera qe kanë qenë te listuara ne listen e kontratave bazuar ne nenin 72 te LPP-së , shih kriterin më posht per te cilin është berë pretendimi : III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 45,000.00 Euro. Dëshmia 1 Lista e shërbimeve të kryera në lëmin e shërbimeve të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Shërbimet e kryera, shumën e kontratës, vendit dhe Nr. e Prokurimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, e përcjellur me Kopje të Referencës përkatëse ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përbushur me sukses. Ekspertja sqaron se qendron prettimi i OE ankues sepse i njejt ka dorezuar listen e kontratave i njejt ka dorezuar edhe referenca por te njejtat nuk i ka dorezuar ato qe janë te ngjashme sepse shumicen e referencave i ka dorzuar per aktivitete per furnizime jo per sherbime edhe pse ne listene kontratave ka listuar shumë kontrata per sherbime te ngjashme e per te cilat AK ka mundur te kerkojë sqarime per referenca apo raporte te pranimit pasiqë sikur u sqarua më lart kishte kontrata te tilla te listuara ne listen e kontratave te realizuara ,eliminimi pa kerkua sqarime nuk është në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së . Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë. Pretendimi 3: Arsyetimi i AK per eliminimin tonë si me poshtë nuk qendron ,shih kriterin më posht per te cilin jemi eliminuar : Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatën ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), Fushë veprimtaria Servisim te pajisjeve mjekësore; Dëshmia 3 Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali; Sa i perket ketij pretendimi i njejt nuk qendron sepse me NJK dhe DT ishte paraparë që te dorëzohet Certifikat valide dhe kopje e noterizuar nga origjinali . Ndersa OE ankues ka dorezuar çertifikaten e noterizuar nga kopja ketë e ka theksuar noteri i cili e ka bërë noterizimin e kesaj çertifikate . Ekspertja sqaron, se kriteret e parapra me NJK dhe DT janë te pa ndryshueshme pasi te kaloj afati per sqarimin e tyre e ne rastin konkret ky kriter është i pa ndryshueshëm është kërkuar kopja e noterizuar nga origjinali ,ndersa OE ankues ka sjellur kopjen e noterizuar nga kopja ,e sa i perket pretendimit te OE ankues se AK ne detale po i shiqon dokumentet e dorezuara nga kjo kompani ,Ekspertja sqaron se është detyrë dhe pergjegjesi e AK që te bejë vlerësimin sipas kerkesave te parapara me NJK dhe DT. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar. Pretendimi 4: i OE Pro Medical ndaj OE të rekomanduar për kontratë nga AK. OE ankues nder te tjera pretendon se ,OE të rekomanduar për kontratë nga AK. kontrata e punës se OE të rekomanduar për Andi Jashari dhe Trinor Salihu pra kontrate nuk janë komplet pra këto kontrata kanë 5 faqe kurse OE i rekomanduar ka dërguar faqen 1 dhe vetëm faqen 5 pra mungoj disa faqe edhe teknikish këto dokumente nuk janë kompletuar por përsëri AK e rekomandon për kontratë. Ekspertja sqaron se ashtu siq ka theksuar OE ankues kontratat per personat e lartpermendur janë dorëzuar siq ka theksuar OE ankues mirëpo ne keto faqe shihen te dhenat e mjaftueshme per ta kuptuar marrdhanjen kontraktuale ne mes te punsuarve dhe ofertuesit ,ofertuesi i rekomanduar perveq ketyre ka sjellur edhe listen e pagave te nxirrë nga ATK qe deshmon se te njejt janë te punsuar te kompania e shpallur fitues. Ekspertja thekson se per ketë kriter duhet te sqarohet se nuk ka pasur nevojë te kerkojë sqarime sepse ky kriter ishte ndryshuar me rastin e publikimit të B54 Formularin standard për korrigjimin me kete formular kriteri i permendur me lart tani është korrigjuar ne ketë formë si : Kërkesa 4 Dy (2) Serviser me certifikate nga prodhuesi per servisim te pajisjeve kryesore Selectra pro m dhe Sfri H18; Kerkesa 4 : (Kjo siq duket ketu ashtu është ne formularin e korrigjimeve) Dy (2) Serviser me certifikata trajnimi për pajisje biokimike dhe hematologjike; Andaj ekspertja sqaron se me ndryshimet e bera kontrata fare nuk ka pasur nevojë te kerkohet sepse e njejta me ndryshimet e bera ishte hequr si kriter,provë referoju „B54 Formularin standard për korrigjimin ”te cilin e gjeni te publikuar në platformen e e-prokurimit. Ekspertja bënë ndarjen e pretendimit më poshtë i cili si pretendim nuk ishte edhe në kerkesë për rishqyrtim si: Gjithashtu kontrate e punëtorëve të cekur me lart janë bërë me daten 05.09.2024 kurse data e dorzimit të

ofertave është 26.08.2024 pra vrehet qart se ky AK e ka favorzuar OE e rekomanduar për kontratë. Andaj te njejtat edhe nuk leshohet ti shqyrtojë pasi që të njejtat nuk ishin pretendime në kerkesen për rishqyrtim . Bazuar në nenin 109 paragrafi 1 Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. (ku pretendimet me lart nuk ishin në kerkesë për rishqyrtim dhe per te njejtat janë vendosur në ankesë në kundërshtim me keto dispozita) si dhe bazuar në Rregulloren nr 01/2020 e punës së OSHP-së neni 13 paragrafi 9 Ankesa duhet të jetë e qartë, e shkurtër dhe me pretendimet e supozuara, që eventualisht janë shkelur nenet e caktuara të LPP-së, nga ana e autoritetit kontraktues. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues, si dhe bazuar në Rregulloren nr .001/2022 për prokurim publik nenin 64.2 Ankesa do të përgatitet dhe dorëzohet tek Organi Shqyrtues i Prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksionit të dedikuar “Ankesat”. Pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.si dhe nenin 19 parg 1 te Rregulloren nr. 01/2020 e punës së OSHP-së Eksperti shqyrtues, ka konstatuar se ka pretendime të cilat nuk i ka parashtuar në kërkesën për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, atëherë eksperti shqyrtues obligohet që ne raport të ekspertizës të bëjë ndarjen e pretendimeve për panelin shqyrtues dhe pretendimet e permendura me lart janë ndarë në harmoni me dispozitat e theksuara më lart. Sqarim: Ekspertja sqaron se qendron pretendimi Autoritetit Kontraktues se AK kishte konstatuar se OE ankues nuk e ka plotësuar kriterin lidhur me kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe per te njejtin kishte kerkuar informacion shtesë permes platformes se e-prokurimit shih kriterin me posht: III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se 60,000.00 Euro. Dëshmia 1: Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë. Ekspertja sqaron se OE ankues nuk kishte dhenë pergjigjeje sa i perket kapacitetit ekonomik dhe finaciuar dhe AK me te drejtë e kishte trajtuar si OE te eliminuar ,sepse detyrë e AK është te kerkojë informacion apo deshmit e nevojshme ,ndersa obligim i OE ishte te ofrojë deshmit e kerkuara nga ana e Autoritetit Kontraktues. Sa i perket pretendimit per shkeljen e nenit 59 te LPP-së dhe 40 Rregullores per prokurim publik Ekspertja sqaron se ky pretendim nderlidhet edhe me pretendimin per shkeljen e nenit 72 te LPP-së dhe duke marrë parasysh vleresimin në tëresi na del se i njejt pretendim është pjesertisht i bazuar,mirëpo konsideroj se edhe po te kthehej landa në rivlerësim nuk do te kemi ndonjë rezultat tjetër sa i perket fituesit sepse OE ankues nuk i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT , ndersa sa i perket pretendimeve për OE e shpallur fitues te njejtat sikurse u sqaruan më lart janë të pa bazuara. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar..

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit dhe duke u bazuar në konstatimet e ekspertit shqyrtues është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, vendos që ankesa e Operatorit

Ekonomik Pro Medical Sh.P.K., të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Rahovecit lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Servisimi i Pajisjeve Mjekësore – Ritenderim” me numër të prokurimit 623-24-8427-2-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: